



Research Coaching Program

Demografia dhe e Ardhmja e Shqipërisë

Instituti i Studimeve Politike “Sami Frashëri”, me mbështetjen e **Center for Advanced Studies, Sarajevë,** zhvillon Programin e Kërkimit dhe Trajnimit “Demografia dhe e Ardhmja e Shqipërisë”, një nismë e strukturuar që synon të trajtojë studentë dhe të rinj të diplomuar në mendim të orientuar drejt së ardhmes dhe të aplikuar në hartimin e politikave publike.

Shqipëria po përballlet me një transformim të thellë demografik, i karakterizuar nga rënia e lindshmërisë, emigracioni i vazhdueshëm, plakja e popullsisë dhe zbrazja e zonave të tëra territoriale. Këto zhvillime nuk përbëjnë vetëm një fenomen statistik, por ndikojnë drejtpërdrejt në strukturën e ekonomisë, funksionimin e tregut të punës, qëndrueshmërinë fiskale, organizimin e jetës familjare, sistemin arsimor dhe atë shëndetësor, si dhe në vetë kapacitetin e shtetit për të planifikuar në afatgjatë. Në këtë kuptim, demografia nuk është një sektor më vete, por një kusht strukturor që ndikon në të gjitha politikatat publike.

Programi ndërtohet mbi nevojën për të kaluar nga një diskutim i fragmentuar dhe shpesh reaktiv mbi të ardhmen e vendit, drejt një qasjeje më të strukturuar, që ndërthur analizën empirike me mendimin perspektiv dhe formulimin e propozimeve konkrete. Qëllimi është të krijohet një hapësirë ku studentët jo vetëm të njihen me këto zhvillime, por të aftësohen për t'i analizuar ato dhe për t'i përkthyer në produkte të mirëfillta politike.

Në qendër të programit qëndron qasja e **policy incubator**, e kuptuar si një proces i drejtuar zhvillimi idesh, i cili ndërthur analizën empirike me mendimin për të ardhmen. Në këtë kuadër, idetë nuk trajtohen si produkte të gatshme, por si elemente që formohen gradualisht përmes një procesi të integruar që përfshin: fotografimin empirik të gjendjes aktuale, diskutimin dhe shkëmbimin kritik të perspektivave, si dhe imagjinimin e skenarëve të mundshëm të së ardhmes. Kjo qasje mbështetet në parimet e future studies, ku e ardhmja nuk trajtohet si një projeksion linear i së tashmes, por si një hapësirë mundësish që mund të analizohet, strukturohet dhe përdoret për orientimin e politikave. Pjesëmarrësit vendosen në një mjedis kërkimor ku problemet publike identifikohen, analizohen në dritën e zhvillimeve të mundshme afatgjata, testohen përmes debatit dhe përkthehen në propozime të strukturuar politike.

Metodologjia e programit ndërthur tre elementë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin.

Së pari, programi fillon me një trajnim intensiv dy-ditor, gjatë të cilit pjesëmarrësit pajisen me bazat e mendimit për të ardhmen dhe analizës së politikave publike. Trajnimi fokusohet në identifikimin e faktorëve strukturorë, ndërtimin e skenarëve të mundshëm, formulimin e problemeve kërkimore dhe organizimin e argumentit në një format politikash. Kjo fazë synon të krijojë një bazë të përbashkët analitike për të gjithë pjesëmarrësit.

Së dyti, pjesëmarrësit angazhohen në një cikël prej dhjetë diskutimesh tematike, të cilat trajtojnë dimensionet ndryshme të zhvillimit të ardhshëm të Shqipërisë. Këto diskutime nuk janë pjesë formale e programit të trajnimit, por funksionojnë si një mjedis paralel intelektual. Studentët ndjekin këto sesione në mënyrë sistematike, duke identifikuar argumente, kundërshti, interpretime dhe implikime politike që lidhen me temën e tyre kërkimore. Në këtë mënyrë, diskutimi shndërrohet në burim material analitik.

Së treti, çdo pjesëmarrës zhvillon një punim politikash (policy paper) prej rreth 10 faqesh, në bashkëpunim të ngushtë me një mentor. Secili student punon mbi një temë të caktuar dhe përgjatë gjithë procesit mbështetet nga

mentori në qartësimin e problemit, përzgjedhjen e evidencës, strukturimin e argumentit dhe formulimin e rekomandimeve. Roli i mentorit është të sigurojë disiplinë metodologjike dhe koherencë analitike, duke e udhëhequr studentin nga ideja fillestare deri në produktin final.

Struktura e programit zhvillohet në mënyrë të integruar. Ai nis me fazën e trajnimit, vijon me përfshirjen në diskutimet tematike dhe zhvillohet paralelisht me procesin e shkrimit të udhëhequr nga mentorët. Në përfundim, çdo pjesëmarrës dorëzon një policy paper të standardizuar, i cili trajton një dimension të veçantë të së ardhmes së Shqipërisë në kushtet e ndryshimeve demografike.

Programi ka tre objektiva kryesore. **Së pari**, të zhvillojë kapacitetet analitike të pjesëmarrësve në fushën e mendimit për të ardhmen dhe analizës së politikave publike. **Së dyti**, të prodhojë një set punimesh politike që adresojnë sfida konkrete të zhvillimit të vendit. **Së treti**, të nxisë një mënyrë të re të menduarit mbi politikat, ku problemet aktuale analizohen në lidhje me zhvillimet e ardhshme dhe me pasojat e tyre afatgjata.

Programi i drejtohet studentëve dhe të diplomuarve të rinj në shkencat sociale dhe fusha të afërta, të cilët shfaqin interes për çështjet publike dhe janë të gatshëm të angazhohen në një proces të strukturuar kërkimor. Pjesëmarrja kërkon përkushtim të plotë ndaj të gjitha fazave të programit, nga trajnimi fillestar deri te dorëzimi i punimit përfundimtar.

Në përfundim, programi i trajnimit synon të kontribuojë në dy drejtime. Nga njëra anë, prodhon njohuri të strukturuar në formën e policy papers që trajtojnë çështje kyçe të së ardhmes së Shqipërisë. Nga ana tjetër, krijon një grup të ri pjesëmarrësish që janë të aftë të analizojnë problemet publike në mënyrë të thelluar, duke i lidhur ato me zhvillimet afatgjata dhe duke propozuar ndërhyrje konkrete politike.

Në këtë kuptim, programi nuk synon vetëm të trajtojë një problem si demografia, por të ndërtojë një praktikë të qëndrueshme të menduarit dhe të veprimit në politikë, ku e ardhmja konsiderohet si një dimension i pranishëm në vendimmarrjen e sotme.